

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENSINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU
--	---	--

SCC-09-0167

Paditësi

1. M.M. nga XX
 2. M.N., nga XX
- Që të dy të përfaqësuar nga avokati XX

kundër.

E paditura

XX, NSH, **XX**,
Përfaqësuar nga **Agjencia e Privatizimit e Kosovës**, rr.Illir Konushevci, No.
8, Prishtinë

Kolegji i parë i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i përbërë nga Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtar Kryesues, Gjyqtar Shkëlzen Sylaj dhe Gjyqtar Qerim Fazliji, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 24 tetor 2012, jep këtë:

AKTGJYKIM

Padia refuzohet si e pabazë.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 3 shtator 2009 paditësit kanë parashtruar padi për të shpallur të pavlefshme kontratën e shitjes, të datës 25 mars 1964, që paraardhësit e tyre S.Z. dhe P.M. e kishin nënshkruar me të paditurën, Kooperativën Bujqësore Industriale XX (NSH) (faqet 14-17 të dosjes). Ata gjithashtu kërkojnë një aktgjykim me të cilin të paditurit detyrohen t'ua kthejnë paditësve pronën që përbën objektin e kontratës, d.m.th. tokën bujqësore me sipërfaqe prej 2.41.80ha, që ndodhet në "Alipasina Cesma", e regjistruar si ngastër kadastrale 116, Zona Kadastrale Fushë Kosovë, lista poseduese 401, dhe ata

detyrohen ta kthejnë çmimin e blerjes. Në rast alternativ, ata kërkojnë që të kompensohen me tokë të llojit të ngjashëm.

Paditësit pretendojnë se paraardhësit e paditësve kanë nënshkruar kontratën e lartpërmendur kundër vullnetit të tyre dhe nën kërcënimin se do të përjashtoheshin nga partia komuniste dhe se familjet e tyre do të humbnin punët e tyre dhe të drejtën për arsimim. Ata pretendojnë se për kushtet e kontratës nuk janë rënë dakord, veçanërisht për çmimin që paraardhësit e tyre e kishin marrë nuk ishte i drejtë dhe nuk korrespondon me vlerën në treg të pronës.

Me urdhër të Kolegjit të datës 8 gusht 2012 AKP-së i ishte kërkuar të dorëzonte një autorizim për të caktuar një avokat i cili është anëtar i Shoqatës së Avokatëve të Kosovës ose Odës së avokatëve, e i cili do ta përfaqësonte para Dhomës së Posaçme.

Arsyetimi ligjor

Pretendimet e të paditurës, të parashtruara nga AKP-ja si përfaqësuese e saj, nuk do të merren në konsideratë, pasi që ato nuk janë parashtruar nga një avokat.

Të gjitha palët, me përjashtim të personave fizik, duhet të përfaqësohen nga një avokat pranë Dhomës së Posaçme (Shtojca, neni 24 i Ligjit Nr.04/L-033 LDHP). Kjo gjithashtu aplikohet edhe për NSH-të e përfaqësuara nga AKP-ja. Formulimit të kësaj dispozite i mungon çdo lloj indikacioni se përse nuk duhet të aplikohet. Nenet 73, 74, 85 dhe 86 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006, LPK), të cilat rregullojnë se kush mund të jetë palë, cilat veprime mund të ndërmarrin palët dhe kush mund të përfaqësojë një palë u mundësojnë palëve dhe përfaqësuesve të tyre, të cilët nuk janë avokatë të regjistruar, që të veprojnë në gjykatë, por sa i përket këtyre dispozitave, neni 24 i Shtojcës së LDHP-së është lex posterior dhe lex specialis. Ligjvënësi ka lëshuar nenin 24 të Shtojcës së LDHP-së, në kohën kur LPK ka ekzistuar dhe me anë të nenit 24 të Shtojcës së LDHP-së rregullohet një procedurë e posaçme për një gjykatë të posaçme, e cila është ndryshe nga gjykatat e tjera të Kosovës. Neni 24 i Shtojcës së LDHP-së gjithashtu zëvendëson nenin 29 të Ligjit mbi AKP-në (04/L-034, Ligji mbi AKP-në) sepse ai është lëshuar më vonë dhe nuk rregullon përfaqësimin në përgjithësi, ashtu siç bënë Ligji mbi AKP-në, por në mënyrë specifike përfaqësimin pranë DHPGJS-së. Kjo gjithashtu është e aplikueshme edhe

për nenin 29.2 të Ligjit mbi AKP-në, i cili rregullon “të drejtën ligjore” të Agjencisë për të kërkuar çfarëdo të drejtash për një ndërmarrje në gjykatën kompetente në emër të asaj ndërmarrje.

Rregulli ligjor që personat fizik nuk kanë nevojë të kenë një avokat, ndërsa të gjithë të tjerët kanë nevojë të kenë një avokat, nuk e shkel nenin 73 dhe 74 të LPK-së. Kjo nuk është e mundur sepse neni 73 dhe 74 nuk janë të aplikueshme. Ato zëvendësohen me nenin 24 të LDHP-së.

Kërkesa që të përfaqësohen nga një avokat nuk është shkelje e të drejtës kushtetuese për çështjen e barazisë para ligjit. Mund të mbetet çështje e hapur nëse AKP-ja si një “organ publik” (neni 1.1 i Ligjit mbi AKP-në) mund të kërkojë të drejtën themelore të barazisë, që historikisht dhe në kontekstin kushtetues është një e drejtë e personave fizik dhe entiteteve private ligjore kundër shtetit, dhe jo një e drejtë e një organi shtetëror kundër shtetit. E paditura ka të drejtë që të trajtohet në mënyrë të barabartë, por barazia kushtetuese nuk nënkupton që çdonjëri të trajtohet në mënyrë të barabartë, pavarësisht nëse ekzistojnë aspekte të arsyeshme dhe jo diskriminuese të diferencimit. Nuk është as e paarsyeshme dhe as diskriminuese që të privilegjojnë personat fizik ndaj entiteteve ligjore (apo një autoritet publik shtetëror) para gjykatës. Shpeshherë, ndoshta jo rregullisht, personat fizik nuk kanë mjetet financiare që të përballojnë angazhimin e një avokati. Sipas aspekteve kushtetuese kjo është një arsye e mjaftueshme pse ata duhet të kenë privilegjin të paraqiten para DHPGJS-së pa ndonjë avokat.

Si rezultat mund të thuhet se e paditura, si çdokush tjetër, me përjashtim të personave fizik, duhet të përfaqësohet pranë Dhomës së Posaçme nga një avokat, i cili është anëtar i odës së avokatëve apo shoqate të avokatëve. Pasi që e paditura nuk është përfaqësuar nga një avokat i regjistruar, duhet të konsiderohet se ajo nuk është paraqitur fare në gjykatë.

Megjithatë, nuk mund të lëshohet një aktgjykim për mosparaqitje (Neni 52.2 i Shtojcës së LDHP-së). Faktet e pretenduara nga paditësi nuk e mbështesin padinë.

1.

Kontrata e shitjes e datës 25.03.1964 në mes të paditësit dhe S.Z. dhe P.M. fillimisht ishte e vlefshme.

Kontrata është lidhur nga të dyja palët që formon dhe shpreh vullnetin për të krijuar rezultatin e njëjtë ligjor. S.Z. dhe P.M. dhe i padituri i kontratës së shitjes së 25.03.1964 kanë dëshiruar që shitja e paluajtshmërisë të ndodhë dhe e kanë shprehur këtë vullnet të përbashkët në kontratën e shitjes. S.Z. dhe P.M. nuk mund të barazohen me personin dora e të cilit është detyruar me forcë të nënshkruaj ose i cili i është nënshtruar dhunës së tillë, që e bënë të pamundshëm formimin e vullnetit të tij. Kërcënimi për t'i përjashtuar ata nga puna dhe nga partia komuniste ka ndikuar në vullnetin e tyre por nuk e ka bërë me të vërtetë të pamundshme që ai të abstenojë nga shitja e tokës.

Është i drejtë vlerësimi i paditësit se Kushtetuta e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë e datës 7 prill 1963 (më tutje: Kushtetuta 1963), e cila atëherë ishte e vlefshme edhe për territorin e Kosovës së sotme nuk e ka lejuar kërcënimin e shfaqur ndaj tij. Të detyrohen pronarët që të shesin nën kërcënim ku për pasojë e kishte shpronësimin , të cilën kushtetuta do ta lejonte vetëm nëse do të bëhej kompensim i drejtë (neni 25, Kushtetuta 1963). Kërcënimi për ta përjashtuar pronarët nga puna nëse ata s'do ta shisnin ka qenë shkelje e drejtave të tyre për punë (neni 36, Kushtetuta 1963) si dhe të drejtat tjera kushtetuese kanë mundur të shkelen me kërcënimin e pronarëve.

Megjithatë, kjo nuk e bën kontratën e shitjes të pavlefshme. Sistemi ligjor mund të zgjedh në mes të shumë opsioneve se si të reagohet ndaj një shkeljeje të kushtetutës. Kjo mund të hap rrugën drejt Gjykatës Kushtetuese, dhe mund t'i jep palës së imponuar të drejtën për revokim, apo mund ta zhvleftësojë kontratën që nga fillimi, ose mund t'i mundësojë kompensim financiar, dhe kështu me radhë. Madje mund edhe të abstenojë nga caktimi i ndonjë pasojë ligjore në një shkelje të kushtetutës, që nënkupton të mbështetet në mënyrë ekskluzive në përgatitjen e autoriteteve për të qenë në përputhje me kushtetutën apo në ndalesën politike të ndonjë shkeljeje. As Kushtetuta e 1963 dhe asnjë ligj i Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë nuk ka përcaktuar se kontratat të cilat janë lidhur me kërcënim jo kushtetues janë vetvetiu të pavlefshme që nga fillimi.

2.

Kontrata ka mbetur e vlefshme.

Kushtetuta e 1963 nuk i ofron paditësit mundësinë e revokimit të kontratës së shitjes.

Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore i Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë i datës 1 tetor 1978 (më tutje: Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore 1978) e rregullon nulitetin e kontratave dhe të kontratave relativisht të pavlefshme dhe si të kërkohet nuliteti (neni 103 deri te neni 117 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore 1978), por ky ligj nuk është i zbatueshëm në mënyrë retroaktive (neni 1106 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore 1978). Prandaj, edhe dispozitat e këtij ligji në lidhje me parashkrimin nuk zbatohen.

Neni 8 i Ligjit të Republikës Socialiste të Serbisë i datës 23.7.1987 me të cilin ndryshohet Ligji Serb mbi Ndryshimet e Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme i vitit 1981 (më tutje: Ligji Serb me Ndryshime i datës 23.7.1987) gjithashtu nuk shpie në pavlefshmërinë e kontratës së shitjes së datës 25.03.1964.

Dispozita përcakton siç vijon:

Kontrata për transferimin e pronës së paluajtshme do të jetë nulë dhe e pavlefshme nëse ajo është lidhur nën presion me përdorimin e dhunës, apo në ato kushte dhe rrethana në të cilat kërcënohet apo nuk arrihet të ofrohet siguria e njerëzve dhe e pronës, ushtrimi i mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe përgjegjësiive të njeriut dhe qytetarit, apo ligjshmëria dhe barazia e kombeve dhe e grupeve etnike.

Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohen edhe në kontratat për transferimin e pronës së paluajtshme të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ky nen nuk është i zbatueshëm në kontratën e datës 25.03.1964.

Transferimi i Pronës së Paluajtshme është rregulluar me Ligjin e vitit 1981 në Serbi nga Kuvendi i Serbisë (Gazeta Zyrtare e Serbisë 43/81, më tutje: Ligji i Serbisë mbi Qarkullimin) dhe në vitin e njëjtë në Kosovë nga Kuvendi Kosovës (Gazeta Zyrtare e Kosovës 45/81, më tutje Ligji i Kosovës mbi Qarkullimin). Ligji Serb me Ndryshime i datës 23.7.1987, sipas nenit 1 të tij vetëm e ka ndryshuar Ligjin Serb mbi Qarkullimin. Legjislatori Serb nuk kishte gjithashtu kompetenca që të ndryshojë ligjin e një legjislature tjetër. Kështu që Ligji i Kosovës mbi Qarkullimin ka mbetur

pa ndryshimin e nenit 8a të legjislacionit serb. Rezultati ishte se sipas Ligjit të Kosovës, kontratat të cilat janë lidhur nën kërcënim mbetën të vlefshme dhe sipas Ligjit të Serbisë ato u bënë të pavlefshme.

Megjithatë, neni 12 i Ligjit të Serbisë për Ndryshimin e Ligjit mbi Qarkullimin përcakton se neni 8 a i Ligjit me Ndryshime do të zbatohet në mënyrë të barabartë në të gjithë territorin e Republikës së Serbisë. Kjo nënkupton se sipas Ligjit të Kosovës, neni 8a nuk ka qenë i zbatueshëm në Kosovë dhe sipas Ligjit serb ka qenë i zbatueshëm. Kushtetua e Serbisë e vitit 1974 megjithëse kërkonte që ligji i krahinës të mos devijonte nga Ligji i Republikës së Serbisë (neni 228 i Kushtetutës 1974) nuk e zgjidhë kontestin vetëm duke thënë se Ligjit i Republikës së Serbisë mbizotëron, por kërkon që ligji krahinor të zbatohet derisa Gjykata Kushtetuese e Republikës së Serbisë të ketë vendosur për kontestin (neni 229 i Kushtetutës 1974). Pasi që nuk është lëshuar një vendim i tillë, neni 8a i Ligjit Serb me Ndryshime i datës 23.7.1987 nuk zbatohet në Kosovë.

Kontrata e datës 25.03.1964, me të cilën paditësi e ka humbur pronësinë e tij mbeten e vlefshme. Prandaj, padia me ligjin e zbatueshëm tani duhet të hedhet poshtë si e pabazuar.

3.

Por, edhe nëse supozohet se neni 8a i Ligjit të Serbisë për ndryshimin e ligjit mbi qarkullimin i datës 23.7.1987 do të zbatohet në Kosovë, nuk do të mund të kërkohej më sot zhvleftësimi i kontratës së datës 25.03.1964. Ajo do të ishte e humbur. Padia e cila kërkon zhvleftësim është dorëzuar në gjykatë 45 vjet pas lidhjes së kontratës dhe 22 vjet pasi që është miratuar Ligji Serb me Ndryshime. Kërcënim i fillestar i cili e ka bërë paditësin të pranojë kontratën ka mundur të vazhdojë me vite, që do ta ndalonte paditësin të kërkojë zhvleftësimin e saj. Megjithatë, paditësi deri në vitin 2009 nuk ka pasur frikë të humb punën e tij apo të përjashtohet nga partia e tij kur të kundërshtojë kontratën e vitit 1964. Komuniteti ligjor, para së gjithash poseduesi i tanishëm i pronës së paluajtshme, do të mund të besonte se një e drejtë e cila nuk është përmbuar për aq shumë vjet do të mbetet e pa përmbuar. Ky mirëbesim meriton mbrojtje dhe mbrojtja bëhet duke e pranuar humbjen.

4.

Kjo nuk do të thotë se paditësi i cili ka pësuar nga trajtimi joligjor kur është kërcënuar për të nënshkruar kontratën e shitjes duhet të mbetet pa zhdëmtim ligjor. Varet nga legjislatori për të ndjekur Propozimin Gjithëpërfshirës të Martti Ahtisaarit për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës – sipas nenit 143 të Kushtetutës së Kosovës i cili zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe madje mbizotëron ndaj vet Kushtetutës – e që në mënyrë eksplicite kërkon që Kosova të adresojë kthimin e pronave. (Neni 6 i Shtojcës VII të Propozimit Gjithëpërfshirës). Para se miratohet një ligj i Kosovës i cili i rregullon çështjet e kthimit të pronave, gjykata nuk mund të jep zgjidhje ligjore për paditësin.

Taksat gjyqësore

Gjykata nuk do të ngarkojë me shpenzime paditësin pasi Presidiumi i Gjykatës deri më tani nuk ka nxjerrë një listë me shkrim të aprovuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Neni 57 paragrafi 2 i Shtojcës). (neni 57 paragrafi 2 i Ligjit për Dhomën e posaçme). Kjo do të thotë se deri më tani nuk ka bazë të mjaftueshme për të ngarkuar me shpenzime.

Këshillë ligjore

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë brenda 21 ditësh tek Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme. Ankesa duhet t'i dërgohet edhe palës tjetër dhe të dorëzohet tek Trupi Gjygues nga ankuesi brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Ankesave dëshminë se e ka dërguar Ankesën edhe tek pala tjetër.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur ankuesit i është dorëzuar aktgjykimi me shkrim.

Kolegji i Ankesave e refuzon ankesën si të papranueshme nëse ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

E paditura mund të parashtrojë një përgjigje pranë Kolegjit të Ankesave brenda 21 ditëve nga data kur atij i është dërguar ankesa, duke i dërguar përgjigjen ankuesit dhe palëve të tjera.

Pasi që përgjigja në ankesë t'i jetë dërguar atij, ankuesi ka 21 ditë afat që të parashtrojë përgjigjen e tij pranë Kolegjit të Ankesave dhe palës tjetër.

Pastaj pala tjetër ka 21 ditë, pasi që përgjigja e ankuesit t'i jetë dërguar atij, që t'i paraqes kundërpërgjigjen e tij ankuesit dhe Kolegjit të Ankesave.

Alfred Graf von Keyserlingk
Gjyqtar Kryesues